



Tirane, 01.11.2021

Komente për paketën fiskale 2022

Keto propozime për rritje të barres fiskale për sipermarrjen, vijnë në një situatë kur sipermarrja akoma vuan pasojat e shkaktuara nga pandemia dhe kur në përfaqësuesit e saj i kishim kërkuar qeverisë një paketë të tretë të ndihmës që nuk u ofrua nga ana e saj. Po të marrim në konsideratë gjithashtu edhe krizën globale të rritjes së çmimeve, në ballafaqohemi me një rritje tjetër të barres fiskale nga qeveria.

Paketa fiskale e cila do të na prezantohet me datë 1 nëntor 2021, DHTI-Tirane, shpreh mendimin dhe nuk e konsideron që është në nivelin e një pakete fiskale. Janë 4 propozime për ndryshime ligjore, që nga vete relacionet perkatese të tyre, vijnë me teper si një obligim i qeverisë ndaj rekomandimeve të bera nga FMN-ja;

DHTI-Tirane, shpreh mendimin se shpërndarja e informacionit paraprak nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për keto ndryshime në ligjet fiskale, nuk mund të quhet i ezauruar, pa bërë një analizë të thelluar dhe propozime që duhet të vijnë nga sipermarrja në kuadër të një pakete të plote fiskale.

Sa më poshtë janë disa komente sipas projektligjeve:

I. Projektligji “Për një shtesë dhe disa ndryshime në ligjin nr. 92/2014, ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar”

Në nenin 1 është parashikuar që, shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e inputeve bujqësore, siç janë



plehtrat kimike, pesticidet, farat dhe fidanët, përveç hormoneve të klasifikuara në kodet 2937 të Nomenklaturës së Kombënuar të Mallrave, **është 10 për qind.**

-Referuar ndryshimit të këtij neni, lidhur me inputet bujqësore, duke vendosur Tvsh me 10%, nuk mund të konsiderohet lehtësi fiskale, por një shtesë barre takse për inputet bujqësore, që do të ndikojnë në rritjen e çmimit të shitjes së tyre nga ana e shoqërive të tregtimit, që është në dëm të fermerëve, me pasoja në koston e çdo produkti bujqësor dhe për rrjedhojë me ndikim në rritjen e çmimeve në treg për produkte bujqësore.

Në nenin 3 është parashikuar propozimi për zëvendësimin e vlerës 50 milionë lekë **me 500 milionë lekë**, lidhur me përjashtimin nga TVSH-ja në import të makinerive dhe pajisjeve që importohen në funksion të realizimit të kontratave të investimeve me këtë vlerë ose me vlerë më të madhe. Jemi të mendimit se nuk mund të konsiderohet stimul për nxitjen e investimeve në bujqësi. Por rritja 10fish e këtij tavanit do ndikojë **ne uljen e interesit të investitoreve** për të investuar në bujqësi, në një kohë kur sipermarrja prej kohësh i ka kërkuar qeverisë stimul fiskal për të nxitur investimet në bujqësi dhe për ta bërë atë sa më konkurruese me vendet e rajonit.

Neni 4 ka parashikuar që, “Norma e kompensimit të prodhuesit bujqësor”, togfjalëshi “...6 për qind.” të zëvendësohet me togfjalëshin “...0 për qind.”.

-Kjo masë vjen si pjesë e rekomandimeve nga FMN për heqjen e skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë dhe zëvendësimin e saj me subvencionim direkt të sektorit të bujqësisë.

II. Propozimi i projektligjit "Për disa shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar",



- Projektligji parashikon vendosjen e një takse prej **100 lek/kg** për importimin ose prodhimin e **qumështit pluhur**. Argumentimi i këtij propozimi synon që të “incentivojë” prodhimin dhe tregtimin në vend të qumështit, me synim mbështetjen e fermerëve vendas.

Industria e perpunimit të qumështit, prej kohësh dhe në mënyrë sistematike ka ngritur zerin lidhur me kapacitetet reale të fermave blegtorale, të cilat nuk janë në gjendje të plotësojnë nevojat e fabrikave të perpunimit të qumështit si nga ana sasiore, cilësore përfshirë edhe sigurinë ushqimore.

-Sipas statistikave të INSTAT Në vitin 2020, sasia gjithsej e qumështit të grumbulluar rezulton rreth 119 mijë tonë, duke pësuar rënie me 14,80 %, krahasuar me vitin 2019. Gjatë kësaj periudhe, sasia e qumështit të lopës të grumbulluar, që perben bazën e furnizimit të industrisë së perpunimit është rreth 101 mijë tonë, duke pësuar rënie me 18,45 %, krahasuar me 2019.

-Numri i gjedhëve në vitin 2020 është 362.583 krerë, duke shënuar rënie me 12,76 %, në krahasim me vitin 2019.

-Si pasojë e rritjes së çmimeve të inputeve bujqësore dhe ushqimeve për kafshë, fermat blegtorale po shkojnë drejt mbylljes. Kjo ka bërë që fabrikat e perpunimit të qumështit të detyrohen dhe të rritin nevojat për import për qumësht. Sipas statistikave për vitin 2020, janë importuar **10.500 ton** qumësht. Importojmë nga rreth 16 vende evropiane dhe nga rajoni, nga më kryesoret janë Italia, Bosnje-Hercegovina, Serbia deri edhe nga Kosova.

-Ndërkohë, në tregun shqiptar importohet edhe **qumësht pluhur**. Për vitin 2020 janë importuar 1130 Ton qumësht pluhur.

- Vendosja e taksës 100 lek kg për qumështin pluhur jo vetëm që nuk i vjen në ndihmë fermerëve shqiptarë, por mbyllë të gjitha iniciativat e industrisë agroperpunuese që prodhojnë produkte, ku si lëndë e parë është qumështi pluhur.



Sipas statistikave tona 70% e 1100 tonë qumësht pluhur që futet në Shqipëri është e raportuar me etiketa të miratuara nga AKU. (pije për horeka Barista, salcera dhe gjizera të ndryshme me përbërje qumësht pluhur në etiketë).

Nderkohë që në asnjë rast nuk do donim të besojmë se kjo nisëm është e lobuar nga importuesit e produkteve të njëjta me përbërje qumësht pluhur, thjesht do donim të besojmë që është një neglizhencë e ekspertëve që kanë hartuar këtë paketë fiskale.

Është e pakonceptueshme që të taksohet lenda e parë (Qumësht pluhur) që përdor industria prodhuese dhe produktet e gatshme të prodhuara kudo por jo në Shqipëri të importohen pa asnjë taksë .

Industria e përpunimit të qumështit propozon:

1. Të përjashtohen nga pagesa e kësaj takse të gjitha fabrikat e përpunimit të produkteve të qumështit apo edhe produktet e tjera për qumësht pluhur, krem qumështi, hurrë qumështi të cilat kanë kartat teknologjike të produktit fundor me përbërje qumësht pluhur;
2. Fabrikat e përpunimit të qumështit, etiketën e produktit duhet ta kenë të miratuar nga Agjensia e Kontrollit Ushqimor AKU, sipas kartës teknologjike.
3. Të paguhet taksë kombëtare 15 leke/liter për të gjitha produktet e qumështit që importohen në Shqipëri, ku përberja e tyre të rezultojë më pak se 95% qumësht lope.
4. Të paguhet taksë kombëtare 150 leke/kg për të gjithë sasinë e kremit të qumështit që importohet në Shqipëri.
5. Të paguhet taksë kombëtare 150 leke/kg për hurrë qumështi që importohet në Shqipëri.



6. Të paguhet taksë kombëtare 16 leke/liter për pijet e homogjenizuara (Barista)

- **Taksa prej 65 lekë/litër mbi karburantin** që përdoret për furnizimin e këtyre mjeteve lundruese në këto zona turistike, shkon në kundërshtim me politiken dhe incentivat që kanë qenë të vendosura për zhvillimin e zonave turistike, për zhvillimin e porteve të jahteve dhe marinave.

-Mendojmë se abuzimet e konstatuara dhe përfitimet e padrejta nga mjetet lundruese për qëllime turistike, flasin për një menaxhim të dobët të strukturave përgjegjëse. Për sa kohë që situatë të tilla nuk mund të mirë menaxhohen, nderhyrje të kësaj natyre nuk e justifikojnë këto ndryshime që është në kundërshtim me politiken nxitëse të Investimeve të huaja të deklaruar nga vete qeveria.

III. “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar

Ky projektligj propozon masa të politikës fiskale në rishikimin e normave të niveleve të akcizës së disa produkteve, si dhe disa rregullime proceduriale të nevojshme për administrimin nga autoriteti doganor për të qënë në përputhje edhe me dispozitat e Kodit Doganor.

Këto ndryshime konsistojnë në sa më poshtë:

-Ndryshimin e nivelit të akcizës për Duhanin dhe nënproduktet e tij.

-Unifikimin e akcizës për “*Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike*”.

-Indeksimin e nivelit të akcizës bazuar në indeksin e rritjes së çmimeve.

-Heqja e rimbursimit të akcizës së lëndëve djegëse për industrinë, të cilat përdoren për nevoja teknologjike të prodhimit të produkteve në këta sektorë (farmaceutika, tullat, çimento, birra dhe nafta bruto).



-Unifikim i procedurave dhe penalteteve me dispozitat e ligjit nr.102/2014 “Kodit Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

-Me anë të këtij projektligji propozohet **heqja e rimbursimit për lëndët djegëse** të konsumuara në serat me ngrohje, për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevoja teknologjike të prodhimit të produkteve në këta sektorë (farmaceutika, agroindustria, tullat, çimeto, birra dhe nafta bruto).

Nje mase e tille per te gjitha sipermarrjet prodhuese, konsiderohet thjeshte mase per te mbushur arken e shtetit, por qe nuk eshte ne mbeshtetje te politikave nxitese qe sot flasin strategjite e qeverise dhe te pretendojme qe do te rritim konkrueshmerine e produkteve dhe sherbimeve.

-Perjetojme nje suate te pershkallezimit te frikshem te rritjes se cmimeve ne tregun global, qeveria ne vend qe te ndihmoje dhe lehtesoje sipermarrjen, ben qe edhe çmimet e produkteve te ketyre industrive te cituara do te rriten.

- Projektligji ka parashikuar gjithashtu, **detyrimin për indeksimin automatik të tarifave specifike të akcizës së mallrave**. Për këtë qëllim, duke filluar nga viti 2022, mbi tarifatat specifike të akcizës për mallra të ndryshme, do të aplikohet çdo vit rritja në vlerë absolute, e cila merr **në konsideratë rritjen e indeksit të çmimeve në përqindje të vitit paraardhës**. Duke patur parasysh se indeksi vjetor i çmimeve në 10 vitet e fundit është rritur mesatarisht **1.5% - 2.2%**, me këtë përqindje parashikohet të rriten edhe nivelet e akcizave të mallrave të akcizueshme, me përjashtim të grupit të duhaneve për të cilat është parashikuar rritje specifike në 5 vitet e ardhshme.

-Gjykojme se **nje mase e tille eshte totalisht e veshtire per tu llogaritur dhe administruar, duke krijuar edhe shume hapsira per abuzime nga strukturat pergjegjese.**

Çdo shtese ne taksen e akcizes ben qe cdo gje te transferohet ne çmimin final tek konsumatori.

-Edhe ne **shtojcen 1** te mallrave te tatueshme me akcize, te ketij projektligji, rezultojne me rritje shkalla e taksimit.



IV. Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”

Ky projektligj synon:

-Rritjen e pagës dysheme të patatueshme, për të ardhurat nga paga në intervalin nga 30,001 lekë/muaj deri në 40,000 lekë/muaj. Për këtë interval pagash tatimi që do të paguhet mbi të ardhurat nga paga është 0%, duke mundësuar që çdo qytetar që siguron më pak të ardhura, të mos paguajë tatim mbi të ardhurat nga paga.

-Reduktimi i normës tatimore me 50% për tatimpaguesit me të ardhura nga paga nga 40,001 lekë/muaj deri në 50,000 lekë/muaj. Këta tatimpagues do paguajnë 0% tatim deri në shumën 30,000 lekë të ardhura mujore nga paga, dhe mbi këtë shumë do paguajnë gjysmën e normës tatimore prej 13% (pra $50% * 13%$). Kjo siguron që qytetarët me më pak të ardhura, të paguajnë tatim më të ulët mbi të ardhurat nga paga.

-Mbështetja e shtresës së mesme, duke rishikuar fashën e sipërme të taksimit progresiv. Tatimi 23% parashikohet të fillojë të aplikohet në pagat mbi 200,000 lekë/muaj, nga 150,000 lekë/muaj që është aktualisht.

-Jemi te mendimit se : referuar tabelës që është e ndarë në tre fasha, fasha e dytë që është kufiri 30.000-50.000, të ketë një normë të thjeshtë prej 5%, e lehtë për llogaritje;

Kryetari

Nikolin JAKA